



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 323, datë 17.09.2020

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ.{...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS
CIVILE DHE NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME
VENDIMET NR. 87, DATË 26.02.2020 DHE NR. 243, DATË 09.07.2020, TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR
KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 87, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, si dhe nr. 243, datë 09.07.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z.Illir Toska,

V E N D O S I :

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR